

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje (furnizim vendosje/instalim kondicionerë inverter” për nevoja të Bibliotekës Kombëtare.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)** Pajisje të ajrit të kondicionuar 39717200-3, Instalime kondicionerësh 45331220-4

**VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 5,165,294 (pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Biblioteka Kombëtare janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

**Argumentimi:** Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence". Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar është përcaktuar se: "Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave".

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.2** Operatori ekonomik për realizimin e montimit të artikujve objekt prokurimi duhet të disponojë licencë të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji për Impiante teknologjike, termike sipas kategorisë:

- **NS 12-A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit)**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me këtë kategori license N.S – 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose rishërbimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për kryerjen e shërbimit të

montimit/instalimit, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e ndryshuar si edhe në VKM-në Nr.943 dt 28.12.2016 për disa shtesa në vendimin Nr. 759 dt 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave për “Licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Ky kriter është kërkuar në mënyrë që të garantohet dhe të sigurohet Autoriteti Kontraktor përfitues që Operatori ekonomik ofertues zotëron kapacitetet dhe përvojën e nevojshme për të instaluar/montuar dhe konfiguruar pajisjet.

**2.3.3** Operatori Ekonomik për kryerjen e shërbimit të montimit të artikujve objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar stafin e tij teknik si më poshtë:

- Të paktën **1 (një) Inxhinier mekanik;**

-Të paktën **1 (një) Inxhinier elektrik**

-Të paktën **2 (dy)Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse;**

Operatori ekonomik në lidhje me stafin teknik të kërkuar më sipër duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

Për inxhinierin mekanik

- Kontratë pune të vlefshme;
- CV
- Diplomë
- Listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Për inxhinierin elektrik

- Kontratë pune të vlefshme;
- CV
- Diplomë
- Listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Për Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse;

- Kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi;  
CV
- Çertifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

**Shënim:** Kriteri Nr.2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Punonjësit e sipërpërmendur kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit. Vendorsja e inxhinierit mekanik dhe instaluesve siguron që procesi i montimit dhe riparimit të pajisjeve të kryhet me standarde të larta profesionale. Kualifikimet dhe eksperiencia e stafit teknik minimizojnë rrezikun e problemeve teknike në pajisje pas instalimit. Kërkimi i diplomave dhe certifikatave garantojnë kualifikimin e personelit të angazhuar në këtë proces. Stafi teknik i kualifikuar sjell efikasitet në procesin e instalimit dhe mirëmbajtjes, duke kursyer kohë dhe burime, si dhe duke shmangur ndërprerjet e mundshme në funksionimin e pajisjeve. Inxhinieri mekanik është i rëndësishëm për të mbikqyrur dhe siguruar instalimin korrekt të pajisjeve. Kjo redukton çdo rrezik që mund të vijë nga instalime jo të sakta. Inxhinieri elektrik përcakton kapacitetin e duhur të linjës elektrike, kabllove, siguresave dhe mbrojtjeve për kondicionerin. Ai parandalon mbingarkesat dhe rreziqet që lidhen me rrjetin ekzistues elektrik, duke bërë llogaritje të sakta të konsumit të energjisë. Siguron që instalimi të jetë në përputhje me standardet elektrike dhe rregulloret ligjore. Parandalon rreziqet si zjarri, goditjet elektrike, qarku i shkurtër, përmes përdorimit të pajisjeve mbrojtëse. Inxhinieri analizon kompatibilitetin/perputhjen me sistemin elektrik të ndërtesës, duke shmangur ndërhyrje që mund të dëmtojnë pajisje të tjera. Mund të projektojë linja të dedikuara për kondicionerin nëse rrjeti ekzistues nuk është i mjaftueshëm. Inxhinieri është i aftë të identifikojë defekte elektrike, të kryejë testime me instrumente profesionale si multimetra, analizatorë të rrjetit etj. Në përfundim, pa praninë e një inxhinieri elektrik, instalimi i kondicionerëve mund të jetë joefikas, i pasigurt dhe jashtë standardeve. Dy instalues, një inxhinier mekanik dhe një inxhinier elektrik në raport edhe me kohën e dorëzimit dhe kryerjes së montimit janë mëse të domosdoshëm për të punuar në mënyrë efektive në realizimin me sukses të kontratës. Lidhur me kërkesën për instaluesit e kondicionerëve AK jo domosdoshmërisht kërkon që instaluesit të jenë staf i qëndrueshëm i ofertuesit të mundshëm ekonomik por mund të kontraktohen nga operatorët ekonomikë të interesuar për realizimin e objektit të prokurimit. Ky përcaktim në këtë mënyrë është bërë duke mbajtur parasysh parimet dhe vetë qëllimin e ligjit të prokurimit sikundër janë nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë siguri i një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; si edhe siguri i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe ti provojnë Autoritetit Kontraktor se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe

*besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën me sukses.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikujt/zërat objekt prokurimi nga 1-7 (kondicionerë). Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** *Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.*

*Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këto pajisje është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit j dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog /skedë teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi, për artikujt/zërat objekt prokurimi nga 1-7 (kondicionerë) duke shënuar/markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu/skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun/skedën teknike të pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Kataloget duhet të jenë të përshkruara në gjuhën shqipe.

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / skedës teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK - Organit Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga*

Autoriteti Kontraktor përfitues për llogari të të cilit Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001:2015(ose e përditësuar)“Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

ISO 14001-2015(ose e përditësuar)“ “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;

**Argumentimi:** Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikatat e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. ( e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë ). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me çertifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm çertifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

*Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Biblioteka Kombëtare për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Specifikimet teknike të pajisjes që është objekt prokurimi janë si më poshtë vijon;*

Specifikimet teknike të pajisjeve objekt prokurimi janë si më poshtë vijon;

Biblioteka Kombëtare është institucion i rëndësishëm, në këtë kuadër nevojitet, marrja e masave për furnizimin e institucionit me materiale pajisje kondicionimi, pasi ka mungesë dhe amortizim pranë institucionit. Për rrjedhojë është e domosdoshme të merret, qoftë dhe një sasi e vogël, për të bërë të mundur mospengimin e punës në institucion. Me kërkesë të Bibliotekës kombëtare, MEKI, ka miratuar fondin për blerje kondicionerësh, me qëllim pajisja me kondicionerë e sallave të leximit (salla e koleksioneve orientale, salla e koleksioneve bizantine) në Qendrën “Sotir Kolea” aneksi i BKS-së, me qëllim plotësimin brenda parametrave teknik të kushteve të klimatizimit, në mënyrë të vecantë të ruajtjes së temperaturës normale për mbajtjen nga demtimi të koleksioneve bibliotekare (dorëshkrime të periudhës së shekullit katërmëdhjetë e në vijim) të ekspozuara në këto salla. Po ashtu në Qendrën Bibliotekare të Digjitimit të Trashëgimisë së Shkruar, si dhe në konsultim me titullarin e institucionit edhe në disa ambiente pune që konsiderohen me të domosdoshmet për pajisjen me kondicionerë.

**Specifikimet Teknike “Blerje pajisje (furnizim vendosje/instalim kondicioner inverter”, janë hartuar nga Komisioni i ngritur për këtë qëllim pranë Autoritetit Kontraktor përfitues “Biblioteka Kombëtare”.**

| Nr. | Emertimi i materialit                                                         |  | Njesia | Sasia | Cmimi All | Vlefte All |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------|--|--------|-------|-----------|------------|
| 1   | Tub bakri(1/4")Ø6 + (1/2")Ø12.7 mm, spesor 0.8mm, me termoizolim δ 9mm        |  | ml     | 150   |           |            |
| 2   | Tubacionet e ajrit te kondicionuar, llamarine zingato δ = (1 ÷ 0.6) mm+Montim |  | kg     | 330   |           |            |

|                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |  |                |    |  |  |
|-------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|----------------|----|--|--|
| 3                                         | Veshje Termoizoluese per tubacionet e kondicionimit (Gome e zeze 9 mm)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |  | m <sup>2</sup> | 45 |  |  |
| 4                                         | Grila dhenies se ajrit kondicionuar 2R, (70 x 15 cm)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |  | cope           | 9  |  |  |
| 5                                         | Grila riqarkullimit te ajrit kondicionuar 45°+F+M, (60 x 20 cm)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |  | cope           | 3  |  |  |
| 6                                         | Atrecature per instalimin e kanaleve dhe grilave te ajrit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |  | set            | 1  |  |  |
|                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |  |                |    |  |  |
| <b>DYSHEME /TAVANOR (LVTB)</b>            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |  |                |    |  |  |
| 1                                         | Kondicioner Inverter Dyscheme /Tavanor <b>18000 BTU/h</b> ; Kapaciteti termik Ftohje Minimum1 4.7 kW. ; Kapaciteti termik Ngrohje Minimumi 6 kW; Fuqia elektrike 1.62 -1.66 kW; SEER=6.1; SCOP=4; Sasia e ajrit Minimumi: 780 m <sup>3</sup> /h; Dimensionet Minimumi: 700*600*199 mm; Niveli Zhurmes Minimumi: 31 dB(A); Temperatura e punes Minimumi 15°C. Klasi Energjise A++/A+ gaz R32, wifi. |  | cope           | 1  |  |  |
| 2                                         | Kondicioner Dyscheme/Tavanor <b>54000 BTU/h</b> , Kapaciteti termik Ftohje Minimumi 13.5 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Minimumi 15.8 kW; Fuqia elektrike 4.65-4.67 kW; SEER=6.1; SCOP=4.1; Sasia e ajrit Minimumi: 2000 m <sup>3</sup> /h; Dimensionet Minimumi: 240*1660*406 mm; Niveli Zhurmes Minimumi: 38 dB(A); Temperatura e punes Minimumi 15°C; Klasi Energjise A++/A+ gaz R32, wifi.      |  | cope           | 3  |  |  |
| <b>Kondicioner Inverter Murale (KMCG)</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |  |                |    |  |  |

|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |  |      |   |  |  |
|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|------|---|--|--|
| 3 | Kondicioner Inverter Mural <b>9000 BTU/h</b> ;<br>Kapaciteti termik Ftohje Minimumi: 2.5 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Minimumi 2.61 kW; Fuqia elektrike 0.63-0.92 kW; SEER=6.1, SCOP=4.1; Sasia e ajrit Minimumi: 420 m³/h; Dimensionet Minimumi: 777*250*201; Niveli i Zhurmes Minimumi 20 dB(A); Temperatura e punës Minimumi 15°C; Klasi Energjise A++/A+ gaz R32, wifi.                 |  | cope | 4 |  |  |
| 4 | Kondicioner Inverter Mural <b>12000 BTU/h</b> ,<br>Kapaciteti termik Ftohje Minimumi: 3.4 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Minimumi: 3.42 kW; Fuqia elektrike 0.935-0.96 kW; SEER= 6.1 - 7.3; SCOP= 4 - 4.4; Sasia e ajrit Minimumi: 550 m³/h; Dimensionet Minimumi: 777*250*201 mm; Niveli Zhurmes Minimumi 40 dB(A); Temperatura e punës Minimumi 15°C; Klasi Energjisë A++/A+ gaz R32, wifi. |  | cope | 4 |  |  |
| 5 | Kondicioner Inverter Mural <b>18000 BTU/h</b> ,<br>Kapaciteti termik Ftohje Minimumi: 5.14; Kapaciteti termik Ngrohje Minimumi: 5.21 kW; Fuqia elektrike 1.39-1.56 kW; SEER= 6.5 - 7.77; SCOP=4 - 4.56; Sasia e ajrit Minimumi: 800 m³/h; Dimensionet Minimumi: 777*250*201 mm; Niveli Zhurmes Minimumi: 29 dB(A); Temperatura e punes Minimumi: 15°C, Klasi Energjise A++/A+ gaz R32, wifi. |  | cope | 4 |  |  |
| 6 | Kondicioner Inverter Mural <b>24000 BTU/h</b> ,<br>Kapaciteti termik Ftohje Minimumi:7.0 kW; Kapaciteti termik Ngrohje minimumi 7.2 kW; Fuqia elektrike 2.08/2.1 kW; SEER=6.5 - 7.28; SCOP = 4 - 4.18; Sasia e ajrit Minimumi: 1000 m³/h; Dimensionet Minimumi: 280*980*210 mm; Niveli Zhurmes Minimumi: 29 dB(A); Temperatura e punes Minimumi:15°C; Klasi Energjise A++/A+ gaz R32, wifi   |  | cope | 9 |  |  |

| Konditioner Inverter Standart Slim (25-90 Pa)<br>ARXG/KATA (Me Pult) |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |  |      |   |  |
|----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|------|---|--|
| 7                                                                    | Konditioner Inverter Duct me presion te mesem statik <b>24 000 BTU/h</b> ; Kapaciteti termik Ftohje Minimumi: 6.8 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Minimumi: 7 kW; SEER=3.18; COP=3.8; Fuqia elektrike 2.14/1.97 kW; Sasia e ajrit Minimumi: 800 m³/h; Dimensionet Minimumi: 210*1135*467 mm; Niveli i Zhurmes Minimumi 25 dB(A); Temperatura e punes Minimumi 15°C; Klasi Energjise A++/A+ gaz R32,wifi |  | cope | 3 |  |
|                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |  |      |   |  |

Specifikimet teknike dhe përlogaritja e fondit limit, jane kryer nepermjet testimit te tregut. Gjithashtu këto specifikime, vijnë në përputhje me rekomandimet e organizatave ndërkombetare te bibliotekave sic jane: “CENL dhe IFLA”. Duke qënë se aspirimi, kondicionimi është ndër kriteret kryesore të jetëgjatësisë së librit, rekomandohet nga këto organizma ndërkombëtar të bibliotekave, që është e detyrueshme funksionimi sa më cilësor i ajrimit, aspirimit, kondicionimit.

Sipas ambjenteve do të vendosen/montohen konditionerë të fuqive të ndryshme, në total 28 copë / pajisje kondicionimi, përkatësisht si më poshtë:

#### **F.V. Konditionerë inverter të tipit mural, me këto specifikime teknike:**

- Pajisje e jashtme dhe e brendshme mono mural;
- Fuqia: 18000 BTU/Orë
- Inverter/klasi i energjisë: A+++ / A+++;
- Tubacione bakri të termoizoluara + kabull komunikimi + kondesat
- Garancia 1 (një) vit nga gata e kolaudimit të pajisjes

#### **F.V. Konditionerë inverter të tipit mural, me këto specifikime teknike:**

- Pajisje e jashtme dhe e brendshme mono mural;
- Fuqia: 24000 BTU/Orë
- Inverter/klasi i energjisë: A+++ / A+++;
- Tubacione bakri të termoizoluara + kabull komunikimi + këndesat
- Garancia 1 (një) vit nga gata e kolaudimit të pajisjes

#### **F.V. Konditionerë inverter të tipit mural, me këto specifikime teknike:**

- Pajisje e jashtme dhe e brendshme mono mural;

- Fuqia: 9000 BTU/Orë
- Inverter/klasi i energjisë: A+++ / A+++;
- Tubacione bakri të termoizoluara + kabull komunikimi + kondesat
- Garancia 1 (një) vit nga gata e kolaudimit të pajisjes

#### **F.V. Kondicionerë inverter të tipit mural, me këto specifikime teknike:**

- Pajisje e jashtme dhe e brendshme mono mural;
- Fuqia: 12000 BTU/Orë
- Inverter/klasi i energjisë: A+++ / A+++;
- Tubacione bakri të termoizoluara + kabull komunikimi + kondesat
- Garancia 1 (një) vit nga gata e kolaudimit të pajisjes

#### **F.V. Kondicionerë inverter të tipit mural, me këto specifikime teknike:**

- Pajisje e jashtme dhe e brendshme;
- Fuqia: 54000 BTU/Orë
- Inverter/klasi i energjisë: A+++ / A+++;
- Tubacione bakri të termoizoluara + kabull komunikimi + kondesat
- Garancia 1 (një) vit nga gata e kolaudimit të pajisjes.

#### **Shënim:**

- Kondicionerë do të vendosen/montohen në vendet e kondicionerëve ekzistues/të vjetër, të cilat do të çmontohen, gjithashtu kondicionerët do të vendosen/montohen në vende të reja, të përshtatshme për cdo ambient.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, janë hartuar nga njësia e prokurimit konform specifkimeve teknike. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

#### **Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

- Dokumentat e tenderit

#### **NJËSIA E PROKURIMIT**

